



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 shkurt 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**

Aleks Uajting

Mbrojtjes së Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Historiku procedural në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të Kadri Veselit ("z. Veseli" ose "i akuzuari") është shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme në lidhje me të. Ngjarjet relevante që nga rishikimi i shtatë i paraburgimit të z. Veseli më 19 dhjetor 2022 ("Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin") përfshijnë sa vijon.¹
2. Më 18 janar 2023, Trupi Gjykues konfirmoi se gjykimi do të fillojë më 1 mars 2023.²
3. Më 30 janar 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrime mbi rishikimin e tetë të paraburgimit të z. Veseli ("Parashtrimet e ZPS-së").³
4. Më 3 shkurt 2023, Mbrojtja e z. Veseli ("Mbrojtja e Veselit") informoi Trupin Gjykues se nuk do t'i përgjigjej Parashtrimeve të ZPS-së, duke mos pranuar asnjë nga parashtrimet e përfshira aty.⁴

¹ KSC-BC-2020-06, F01171, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit*, 19 dhjetor 2022.

² KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës (Konferenca Përgatitore për Gjykim), 18 janar 2023, f 1904, rreshtat 1-3.

³ KSC-BC-2020-06, F01234, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit*, 30 janar 2023, konfidencial. Parashtrimi i protokolluar u riklasifikua si publik më 2 shkurt 2023.

⁴ KSC-BC-2020-06/CRSPD170, mesazh elektronik i Mbrojtjes së Veselit me datë 3 shkurt 2023, në orën 10:53.

5. Më 15 shkurt 2023, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të pakundërshtuar të Mbrojtjes për shtyrjen e fillimit të gjykimit dhe urdhëroi fillimin e gjykimit të kësaj çështjeje më 3 prill 2023.⁵

II. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja parashtron se paraburgimi i z. Veseli duhet të vazhdojë. Sipas ZPS-së, që nga vendimi i fundit mbi paraburgimin më 19 dhjetor 2022, nuk ka pasur zhvillime të reja që dobësojnë faktorët për domosdoshmërinë dhe arsyeshmërinë e paraburgimit. ZPS-ja parashtron se caktimi i datës për fillimin e gjykimit dhe ngjarje të tjera në këtë çështje shtojnë domosdoshmërinë për paraburgimin.⁶

7. Mbrojtja e Veselit vendosi të mos përgjigjej.⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Dispozitat ligjore përkatëse për të vendosur në çështjen aktuale përfshihen në nenin 41 dhe rregullat 56 dhe 57 dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme. Trupi Gjykses do t'i zbatojë këto standarde në këtë vendim.⁸

IV. DISKUTIM

9. Qëllimi i rishikimit të paraburgimit çdo dy muaj sipas nenit 41(10) është që Trupi Gjykses të përcaktojë nëse ekzistojnë ende arsytet për mbajtjen në

⁵ Transkripti (versioni jopërfundimtar) (konferenca përgatitore për gjykim, e Prokurorit të Specializuar), 15 shkurt 2023, f. 2038 (urdhri gojor 1).

⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1,5, 30.

⁷ Transkript (version jopërfundimtar) (Konferenca Përgatitore për Gjykim e Prokurorit të Specializuar), 15 shkurt 2023, f. 1933.

⁸ *Shih, mes shumë të tjerash, KSC-BC-2020-06, F00576, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim mbi Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit*, 23 nëntor 2021, konfidencial, para. 41, me referenca të mëtejshme. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 dhjetor 2021, F00576/RED.

paraburgim.⁹ Ndryshimi i rrethanave, ndonëse nuk është përcaktues, do të merret parasysh në qoftë se ngrihet para trupit gjykues përkatës ose *proprio motu*.¹⁰

10. Vlerësimi i Trupit Gjykues kufizohet në rishikimin e faktorëve të shqyrtuar më parë sipas nenit 41(6) të Ligjit dhe në përcaktimin nëse këto rrethana vazhdojnë të ekzistojnë në mungesë të ndonjë zhvillimi të ri.

A. KRITERET E NENIT 41

i. Dyshimi i bazuar

11. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) fillimisht kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara ("DHS"). Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.¹¹

12. ZPS-ja parashtrohet se vijon të përmbushet kriteri i nenit 41(6)(a). Për mendimin e ZPS-në, nuk ka pasur zhvillime të reja që mund të ndryshojnë konstatimin e mëparshëm të Gjykatës të Procedurës Paraprake se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Veseli është penalisht përgjegjës për krimet e përfshira në Aktakuzën e Ndryshuar, sikurse është konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.¹²

13. Trupi Gjykues vëren se, në bazë të nenit 39(2), Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Veseli është penalisht përgjegjës për një numër krimesh kundër njerëzimit (përndjekje, burgosje, akte të

⁹ KSC-BC-2020-06, IA022/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit* ("Vendimi i Katërt i Apelit mbi Paraburgimin"), 22 gusht 2022, konfidencial, para. 37. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA022/F00005/RED.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, IA010/F00008, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit* ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin"), 27 tetor 2021, konfidencial, para. 19. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA010/F00008/RED.

¹¹ *Për ngjashmëri*, ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222.

¹² Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) dhe krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a).¹³ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se dyshimi i bazuar mirë është vërtetuar edhe në lidhje me akuzat e reja të ngritura nga ZPS-ja kundër z. Veseli, të paraqitura në ndryshimet e kërkuara që i janë bërë Aktakuzës.¹⁴ Trupi Gjykues rikujton gjithashtu se këto konstatime janë bërë mbi bazën e një standardi edhe më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a).¹⁵

14. Në mungesë të ndonjë rrethane të re thelbësore që do të ndikonte në konstatimet e mësipërme, Trupi Gjykues gjykon se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Veseli ka kryer krime që përfshihen në juridiksionin lëndor të DHS-së, të parapara në nenin 41(6)(a) dhe (10).

¹³ KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 521(a)(i)-(ii). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED. Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar në F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020, publike; F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më Pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar* KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial. Versioni i korrigjuar më tej i Aktakuzës u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, Prokurori i Specializuar dorëzoi versionin konfidencial, të korrigjuar dhe me më pak redaktime të Aktakuzës së Konfirmuar, F00647/A01. Aktakuza e ndryshuar e konfirmuar u dorëzua më 29 prill 2022 ("Aktakuza e Konfirmuar"), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05). Versioni konfidencial i ndryshuar i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 30 shtator 2022, (F00999/A01) dhe versioni i redaktuar publik (F00999/A03). KSC-BC-2020-06, IA008/F00004, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit* ("Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit"), 1 tetor 2021, konfidencial, para. 24. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA008/F00004/RED.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 183. Versioni i redaktuar konfidencial (F00777/CONF/RED) dhe versioni i redaktuar publik (F00777/RED) u dorëzuan, përkatësisht, më 22 prill 2022 dhe 6 maj 2022. Versioni konfidencial me më pak redaktime u dorëzua më 16 maj 2022 (F00777/CONF/RED2). Ndryshimet e kërkuara paraqiten me hollësi në para. 11.

¹⁵ Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 21.

ii. Domosdoshmëria e paraburgimit

15. Në lidhje me arsyet për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(b) përcakton tri arsye (rreziqe) alternative në bazë të të cilave mund të konstatohet se paraburgimi është i domosdoshëm: (i) rreziku i arratisjes; (ii) rreziku i pengimit të ecures së procesit; ose (iii) rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera.¹⁶ Paraburgimi vazhdohet në qoftë se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se një ose më shumë prej këtyre rreziqeve do të materializohen.¹⁷ Trupi Gjykses vë në dukje se “të artikulueshme” në këtë kontekst përdoret në kuptimin që arsyet duhet të specifikohen me hollësi, duke iu referuar informacionit ose provave relevante.¹⁸ Në përcaktimin nëse ekziston ndonjëri prej rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b), standardi i zbatueshëm është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që ndonjë prej rreziqeve të materializohet.¹⁹

(a) Rreziku i arratisjes

16. ZPS-ja rikujton se Trupi Gjykses në vendimin e vet të fundit konstatoi se, në atë moment, vazhdimi i paraburgimit të z. Veseli nuk mund të përligjej vetëm me rrezikun e arratisjes.²⁰ Megjithatë, ZPS-ja parashtro se njohuritë më të plota të z. Veseli për çështjen gjyqësore dhe provat, së bashku me mundësinë e dënimit me burgim të gjatë, marrin edhe më shumë rëndësi në kontekstin e caktimit duke pasur parasysh caktimin e datës së fillimit të gjykimit, që do të përshpejtojë nxjerrjen e informacionit gjithnjë e më të ndjeshëm. Në lidhje me dënimin, ZPS-ja

¹⁶ *Krahaso ECtHR, Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016 (“*Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC]”), para. 88; ECtHR, *Zohlandt v. the Netherlands*, no. 69491/16, 9 February 2021, [Judgment](#), para. 50; ECtHR, *Grubnyk v. Ukraine*, no. 58444/15, 17 September 2020, [Judgment](#), para. 115; ECtHR, *Korban v. Ukraine*, no. 26744/16, 4 July 2019, [Judgment](#), para. 155.

¹⁷ KSC-BC-2020-06, IA004/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendimi mbi Apelin e Thaçit lidhur me Lirimin e Përkohshëm”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 19. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA004/F00005/RED.

¹⁸ Neni 19.1.30 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2012, Ligji nr. 04/L-123 jep këtë përkufizim për termin “i artikulueshëm”: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet”.

¹⁹ Vendimi mbi Apelin e Thaçit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, para. 17.

²⁰ Parashtrimi i ZPS-së, para. 9.

argumenton se dënimi me 26 vjet burgim që iu dha kohët e fundit të akuzuarit në çështjen *Mustafa* në lidhje me akuza për krime që përfshihen edhe në këtë çështje shton, në këndvështrimin e të akuzuarit, mundësinë e dënimit me burgim më të gjatë për të.²¹

17. Trupi Gjykses i shqyrtoi argumentet e ZPS-së bazuar në fazën e tanishme të procesit dhe rikonfirmon se nuk konstaton faktorë të tjerë mjaftueshmërisht bindës që ai ta ndryshojë konstatimin e mëparshëm në lidhje me rrezikun e arratisjes.

18. Sa i përket argumentit të ZPS-së në lidhje me ecurinë e procesit, Trupi Gjykses vë në dukje se nuk është bindës argumenti i përgjithshëm i ZPS-së se është shtuar rreziku i arratisjes për shkak të konfirmimit dhe caktimit të datës së fillimit të gjykimit. Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka vërtetuar pretendimin e vet se ekziston “mundësi mjaftueshmërisht reale” që i akuzuari të arratiset në qoftë se lirohet, bazuar në fazën aktuale të procesit.²²

19. Në lidhje me argumentin e ZPS-së se Aktgjykimi në çështjen *Mustafa* e shton mundësinë e një dënimi me burgim më të gjatë për z. Veseli, Trupi Gjykses konstaton se kjo nuk përbën provë për një rrezik më të madh për arratisje. Rreziku për dënim me burgim më të gjatë nuk është më i madh tani sesa ka qenë më parë dhe parashtrimet e ZPS-së për këtë pikë duket se i kushtojnë pak rëndësi faktit se z. Veseli ende presumohet i pafajshëm.

20. Trupi Gjykses i ka shqyrtuar argumentet e ZPS-së bazuar në fazën e tanishme të procesit dhe, megjithëse rreziku i arratisjes nuk mund të përjashtohet asnjëherë plotësisht, rikonfirmon se nuk konstaton faktorë të tjerë mjaftueshmërisht bindës që ai të ndryshojë konstatimin e mëparshëm në lidhje me rrezikun e arratisjes.

²¹ Parashtrimi i ZPS-së, para. 9-11.

²² Vendimi mbi Apelin e *Thaçit* lidhur me Lirimin e Përkohshëm, para. 24.

21. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se, në këtë moment, vazhdimi i paraburgimit të z. Veseli nuk mund përlligjet bazuar në rrezikun e arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i).

(b) Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

22. ZPS-ja parashtron se z. Veseli vazhdon të përbëjë rrezik për pengimin e procesit.²³ ZPS-ja argumenton se nuk ka pasur asnjë ndryshim në lidhje me përfundimet e Trupit Gjykses në vendimin e fundit, përveç përsheptimit të tyre nëpërmjet caktimit të datës për fillimin e gjykimit, dhe, për rrjedhojë, ende ekziston rreziku që z. Veseli mund të ndërhyjë në ecurinë e procesit. Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se në Kosovë vazhdon të ekzistojë atmosfera e frikësimit të dëshmtarëve dhe e ndërhyrjes në proceset penale kundër anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"), në veçanti në lidhje me hetimet/ndjekjet penale për krime që u atribuohen ish-anëtarëve të UÇK-së. Së fundi, ZPS-ja shton se rreziku i pengimit të procesit është shtuar duke marrë parasysh informacionin që z. Veseli ka marrë kohët e fundit në lidhje me, ndër të tjera, 40 dëshmtarët e parë, dhe, me afrimin e fillimit të gjykimit, masat mbrojtëse, si shtyrja e nxjerrjes së informacionit të një numri gjithnjë e më të vogël të dëshmtarëve që do të jenë ende objekt i këtyre masave, do të hiqen.²⁴

23. Trupi Gjykses tërheq vëmendjen në lidhje me standardin e përdorur në vlerësimin e rreziqeve sipas nenit 41(6)(b), i cili nuk kërkon "shembull konkret" të një shtate ku z. Veseli ka frikësuar apo ka ndërhyrë personalisht te një dëshmtar.

24. Trupi Gjykses tashmë ka përcaktuar dhe rikonfirmon se: (i) z. Veseli ka aftësinë t'i japë udhëzime për një individ që ndërvepron me DHS-në dhe, duke e bërë këtë, ndërhyri drejtpërdrejt në një aspekt që ka të bëjë me DHS-në;²⁵ (ii) z. Veseli

²³ Parashtrimi i ZPS-së, para. 12.

²⁴ Parashtrimi i ZPS-së, para. 12-19.

²⁵ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 44; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 38; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 35; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 34; Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin, para. 52; Vendimi i Katërt mbi Paraburgimin, para. 32; Vendimi i Pestë mbi

vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në Kosovë për shkak të posteve të mëparshme të tij,²⁶ që do të vazhdojë t'i mundësojë, për shembull, që të ketë qasje në informacion ose të kërkojë mbështetjen e të tjerëve;²⁷ (iii) në kohën kur z. Veseli ishte shef i Shërbimit Informativ të Kosovës ("SHIK"), anëtarë të SHIK-ut u përfshinë në ndërhyrje ndaj dëshmitarëve;²⁸ (iv) vazhdon të ekzistojë atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në proceset penale kundër ish- anëtarëve të UÇK-së në Kosovë, e cila nuk mund të përmirësohet vetëm me masa mbrojtëse;²⁹ dhe (v) me ecurinë e procesit gjyqësor, z. Veseli vazhdon të njihet me provat që mbështesin akuzat e rënda kundër tij.³⁰

25. Sikurse u theksua më parë, duke marrë parasysh fillimin e afërt të gjykimit dhe se emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të cenueshëm janë nxjerrë dhe do të vazhdojnë të nxirren për Mbrojtjen e Veselit dhe, për rrjedhojë, do të bëhen të njohura për shumë persona, përfshirë të akuzuarin. Kjo, nga ana tjetër, shton rrezikun që informacion i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun përpara se këta dëshmitarët të japin dëshmi. Në këtë aspekt,

Paraburgimin, para. 24; Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 24 dhe Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin para. 28.

²⁶ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 39 dhe 43; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin; 35; Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin, para. 52; Vendimi i Katërt mbi Paraburgimin, para. 32; Vendimi i Pestë mbi Paraburgimin, para. 24; Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 24 dhe Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 28.

²⁷ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 43; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 40; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 35; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 34; Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin, para. 52; Vendimi i Katërt mbi Paraburgimin, para. 32; Vendimi i Pestë mbi Paraburgimin, para. 24; Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 24 dhe Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 28.

²⁸ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 43; Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin, para. 52; Vendimi i Tretë i Gjykatës së Apelit, para. 22-24; Vendimi i Katërt mbi Paraburgimin, para. 32; Vendimi i Pestë mbi Paraburgimin, para. 24; Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 24 dhe Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 28.

²⁹ Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 25, që i referohet KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Trupi Gjyqësor II, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit, 18 maj 2022, publik, para. 577 dhe Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 28.

³⁰ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 39; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 35; Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin, para. 55; Vendimi i Katërt mbi Paraburgimin, para. 34; Vendimi i Pestë mbi Paraburgimin, para. 27; Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 39 dhe Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 28.

lirimi i një të akuzuari në dijeni të informacionit të ndjeshëm nuk do të ndihmonte në mbrojtjen efikase të dëshmitarëve që ende nuk kanë dhënë dëshmi.³¹

26. Gjithashtu, Trupi Gjykses i bën këto konstatime bazuar në informacionin se në Kosovë ekziston një atmosferë e përgjithshme e frikësimit të dëshmitarëve në lidhje me këtë apo me çështje të tjera gjyqësore në DHS. Sikurse u konstatua në Aktgjykimin *Mustafa*:

Ekziston një atmosferë e përgjithshme e frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të Dhomave të Specializuara, familjeve të tyre dhe më gjerësisht kundër atyre që japin dëshmi në hetimet ose ndjekjet penale të krimeve që pretendohet se u kryen nga anëtarë të dikurshëm të UÇK-së. Dëshmitarët stigmatizohen si “tradhtarë” ose “bashkëpunëtorë”, nuk mund të flasin lirshëm për ngjarjet që kanë përjetuar, janë objekt i kërcënimeve dhe frikësimeve dhe jetojnë me frikën e vazhdueshme se do t’u ndodhë diçka atyre vetë ose familjeve të tyre.³²

27. Po ashtu, Paneli i Gjykatës së Apelit në çështjen gjyqësore *Gucati dhe Haradinaj* ka theksuar kohët e fundit rëndësinë e këtyre rrethanave, duke mbështetur vlerësimin e Trupit Gjykses se ekzistonte kërcënim i rëndë ndaj “administrimit të duhur të drejtësisë, integritetit dhe sigurisë së proceseve gjyqësore dhe, çka është më e rëndësishme, sigurisë, mirëqenies dhe çlirimit nga frika të qindra personave, të cilët janë paraqitur për të përmbushur detyrën e tyre qytetare si dëshmitarë.”³³

28. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së.

(c) Rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera

29. ZPS-ja rikujton konstatimet e Trupit Gjykses në Vendimin e Shtatë mbi Paraburgimin dhe parashton se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli të kryejë

³¹ Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 29.

³² KSC-BC-2020-05, F00494/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit* (“Aktgjykimi *Mustafa*”), 19 janar 2023, para. 57. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 24 janar 2023, F00494/REDCOR).

³³ KSC-CA-2022-01, F00114, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Aktgjykim i Apelit*, 2 shkurt 2023, para. 438 (ku citohet KSC-BC-2020-07, Transkripti, 18 maj 2022, f. 3858-3859).

vepra penale të tjera. Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se ekziston rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera duke marrë parasysh atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve lidhur me krimet e UÇK-së dhe ndikimin që z. Veseli ushtron në të.³⁴

30. Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta në Vendimin e Shtatë mbi Paraburgimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli të kryejë vepra penale të tjera. Trupi Gjykses konstaton se të njëjtët faktorë që u morën parasysh në lidhje me rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit vlejné edhe në shqyrtimin e rrezikut që z. Veseli të kryejë vepra penale të tjera. Bazuar në to, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka ndryshuar asnjë nga rrethanat që nga rishikimi i fundit mbi paraburgimin që do të përligjnin një konstatim të ndryshëm në lidhje me këtë pikë.³⁵

31. Trupi Gjykses thekson faktin se gjykimi i kësaj çështjeje do të fillojë pas përafërsisht gjashtë javësh, se identitetet e dëshmitarëve të cënueshëm janë nxjerrë për Mbrojtjen dhe se duhet të shmanget çdo rrezik i kryerjes së veprave penale të tjera.

32. Trupi Gjykses gjykon se, duke marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli të kryejë vepra penale sipas nenit 41(6)(b)(iii).

iii. Përfundim

33. Trupi Gjykses arrin në përfundimin se në këtë moment, informacioni që ka është i pamjaftueshëm për të justifikuar konstatimin se z. Veseli mund të përpiqet t'i ikë drejtësisë. Gjithsesi, Trupi Gjykses është bindur se, sipas këtij standardi, ekziston rreziku që z. Veseli të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së dhe të kryejë

³⁴ Parashtrimi i ZPS-së, para. 20-22.

³⁵ Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 34.

vepra penale të tjera kundër atyre që konsiderohet se janë kundër UÇK-së, ndër të cilët dëshmitarë që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore dhe/ose pritët të paraqiten në DHS. Trupi Gjykses në vijim do të vlerësojë nëse kushtet për lirim të tij trajtojnë në mënyrë të mjaftueshme këto rreziqe.

B. MASAT ALTERNATIVE NDAJ BURGIMIT

34. ZPS-ja parashtrohet se që nga Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin nuk ka ndryshuar asgjë që do të përligjete një vlerësim të ndryshëm të kushteve, qoftë në përgjithësi apo për një periudhë të caktuar kohore. Sipas vlerësimit të ZPS-së, caktimi i datës së fillimit të gjykimit dhe nxjerrjet e mëtejshme të materialit shoqërues i shtojnë rreziqet konkrete më shumë se kurrë.³⁶

35. Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve në nenin 41(6)(b).³⁷ Në nenin 41(12) renditen një numër faktorësh që duhet të mbahen parasysh për të siguruar praninë e të akuzuarit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo për të siguruar kryerjen me sukses të procesit penal. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton se paraburgimi duhet të vazhdojë vetëm në qoftë se nuk ekzistojnë masa alternative më të buta dhe të disponueshme në mënyrë të arsyeshme të cilat do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).³⁸ Për këtë arsye, Trupi Gjykses duhet të

³⁶ Parashtrimi i ZPS-së, para. 25.

³⁷ Në lidhje me detyrimin për të shqyrtuar "masa alternative", shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar*, 26 prill 2017, publik, para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012 ("*Idalov v. Russia* [GC]"), para. 140 *in fine*.

³⁸ Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 26 prill 2017, para. 114; KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020* ("Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 22 maj 2020") 22 maj 2020, para. 70. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], para. 140 *in fine*.

shqyrtojë të gjitha masat alternative të arsyeshme që mund të vendosen dhe jo vetëm ato që parashtron Mbrojtja e Veselit dhe ZPS-ja.³⁹

36. Në lidhje me rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së dhe të kryerjes së veprave penale të tjera, Trupi Gjykses konstaton se as kushtet e propozuara më parë dhe as masat shtesë të parapara në nenin 41(12), të urdhëruara *proprio motu*, nuk mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese.⁴⁰ Trupi Gjykses konstaton se masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të para në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar paraprakisht, me synimin për të zvogëluar rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera.⁴¹ Për më tepër, ato ofrojnë një mjedis të kontrolluar ku një shkelje e mundshme e konfidencialitetit mund të identifikohet dhe/ose parandalohet me lehtësi.⁴²

37. Trupi Gjykses arrin në përfundimin se komunikimet e z. Veseli mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera vetëm me anë të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁴³

38. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së veprave penale të tjera mund të trajtohet në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së. Në këto rrethana, Trupi Gjykses gjykon se

³⁹ KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Gjykata e Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, para. 86.

⁴⁰ *Shih* Vendimin e Tretë mbi Paraburgimin, para. 99; Vendimin e Katërt mbi Paraburgimin, para. 45; Vendimin e Pestë mbi Paraburgimin, para. 37; Vendimin e Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 39 dhe Vendimin e Shtatë mbi Paraburgimin, para. 41.

⁴¹ *Shih* Vendimin e Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 46. *Shih gjithashtu* Vendimin e Tretë mbi Paraburgimin, para. 81; Vendimin e Katërt mbi Paraburgimin, para. 72.

⁴² Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 31.

⁴³ Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 39 dhe Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 41.

vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm për të shmangur rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii).

C. ARSYESHMËRIA E PARABURGIMIT

39. ZPS-ja parashtron se mbajtja në paraburgim e z. Veseli vazhdon të jetë proporcionale dhe e arsyeshme, duke vënë në dukje se po vazhdojnë të ndërmerren hapa të rëndësishëm dhe të shpejtë.⁴⁴

40. Trupi Gjykses rikujton se arsyeshmëria e vazhdimi të paraburgimit të të akuzuarit duhet të vlerësohet në bazë të fakteve të secilës çështje dhe sipas veçorive të saj.⁴⁵ Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, veçoritë në këtë çështje janë: (i) ndaj z. Veseli janë ngritur dhjetë akuza për krime të rënda ndërkombëtare në të cilat pretendohet se ai ka luajtur rol të rëndësishëm;⁴⁶ (ii) mundësia e dënimit me burgim të gjatë, në qoftë se z. Veseli shpallet fajtor;⁴⁷ (iii) rreziqet e përcaktuara në nenin 46(b)(ii) dhe (iii) nuk mund të zvogëlohen me kushtet e propozuara dhe as me një/ose të gjitha kushtet e tjera shtesë;⁴⁸ (iv) çështja gjyqësore kundër z. Veseli është komplekse;⁴⁹ dhe (v) ecuria drejt fillimit të gjykimit, i cili është planifikuar të fillojë në më pak se gjashtë javë.

41. Duke marrë parasysh zhvillimet e mësipërme, si edhe faktin se rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera vazhdojnë të ekzistojnë, asnjë prej të cilëve nuk mund të zvogëlohet mjaftueshëm me zbatimin e masave të arsyeshme alternative, Trupi Gjykses konstaton se vazhdimi i paraburgimit të z.

⁴⁴ Parashtrimi i ZPS-së, para. 26, 28.

⁴⁵ Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 45.

⁴⁶ Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 43 me referenca të mëtejshme dhe Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 46.

⁴⁷ Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 43 me referenca të mëtejshme dhe Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 46.

⁴⁸ *Shih* para. 36 më lart.

⁴⁹ Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin, para. 107 me referenca të mëtejshme dhe Vendimi i Shtatë mbi Paraburgimin, para. 46.

Veseli me dy muaj të tjerë është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm në rrethanat e veçanta të kësaj çështjeje.

42. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se i akuzuari tashmë është mbajtur në paraburgim për një periudhë të konsiderueshme kohore dhe gjykimi i kësaj çështjeje ka mundësi të zgjasë.

43. Sikurse u vu në dukje më herët nga Trupi Gjykses, kjo kërkon si nga Trupi Gjykses, ashtu edhe nga palët, që të kenë veçanërisht parasysh të sigurojnë kryerjen sa më të shpejtë të gjykimit. Trupi Gjykses do të vazhdojë të monitorojë në çdo fazë të këtij procesi nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

V. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli; dhe
- b) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit, jo më vonë se të hënë, 27 mars 2023, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 17 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë.